



AVOKATI I POPULLIT
Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

NJOFTIM

PËR

SHPALLJEN E REKRUTIMIT TË 1 (NJË) EKSPERTI TË JASHTËM

Pozicioni:	Ekspert Lokal
Vendodhja:	Shqipëri
Fillimi i Punës:	15.09.2023
Mbarimi i Punës:	14.10.2023
Kohëzgjatja:	12 ditë punë

Projekti

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, njëkohësisht institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut me Status A, dhe në rolin e vet si Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, është përzgjedhur si Institucioni shqiptar partner për projektin nr. 101007425 SERENY "*Forcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës*" (*Strengthening approaches for the prevention of youth radicalisation in prison and probation settings*), mbështetur nga Programi Drejtësisë i BE-së.

Projekti 2-vjeçar SERENY "Forcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës " në shtatë vende anëtare të BE-së (IT-ES-AT-SLO-DE-FR-BE) dhe Shqipëri, synon të promovojë miratimin e ndërhyrjeve efektive, të bazuara në fakte, në lidhje me parandalimin e proceseve të radikalizimit tek të dënuarit e moshës së re, duke

respektuar të drejtat e tyre të njeriut të garantuara nga ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare të BE-së dhe të KiE.

Objektivi

Avokati i Popullit kërkon të rekrutojë një Ekspertë i cili do të angazhohet për realizimin në anglisht dhe shqip, të Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të projektit nr. 101007425 *SERENY “Forcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës”* specifikisht për Shqipërinë, në të cilën përfshihet nga data e fillimit të projektit 15.10.2021 deri në përfundimin e tij datë 14.10.2023.

Eksperti do të duhet të njihet me projektin dhe ecurinë e deritanishme, të dokumentojë zhvillimet e të sigurojnë realizimin e Raportit Përfundimtar të Vlerësimit, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Institucionit për mundësimin e gjithë aspekteve të lidhura me projektin.

Komunikimi i vazhdueshëm dhe ndarja e informacionit midis Ekspertve dhe Menaxherit të Projektit, kryhet përmes mjeteve online të përdorura zakonisht (Google Drive, Dropbox, email, etj.).

Detyrat dhe përgjegjësitë

Për sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit, do të kontraktojë një Ekspert i cili do të jetë përgjegjës për:

- Mledhjen, përpunimin dhe administrimin e të gjitha të dhënave dhe dokumentacionit përkatës që ka realizuar nga aktivitetit e kryera në kuadër të projektit.
- Hartimin e një metodologjie përpunimi të të dhënave si dhe strukturës së raportit të vlerësimit në konsultim me strukturat e Avokatit të Popullit.
- Realizimin në kohë cilësi dhe sipas standardeve të parashikuara në projekt duke u bazuar në rezultatet e arritura deri më tani nga kryerja e intervistave me të dënuarit dhe realizimi i fokus grupit, tryezë së rrumbullakët, workshop, etj.).
- Konkluzione dhe rekomandime.

- Hartimin e Raportit Përfundimtar të Vlerësimit të projektit nr. 101007425 *SERENY “Forcimi i gasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në mjediset e burgut dhe të shërbimit të provës”* specifikisht për Shqipërinë nga data 15.10.2021 deri në 14.10.2023.
- Hartimin e Raportit Përfundimtar të Vlerësimit në dy gjuhë, anglisht dhe shqip.

Kriteret e veçanta

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
- Të ketë eksperiencë në kërkim infomacioni dhe hartim dokumentash/ raportesh.
- Të ketë eksperiencë në hulumtim implementim dhe menaxhim projektesh.
- Të ketë eksperiencë pune në fushën e të drejtave të njeriut.
- Të ketë zotërim të mirë të gjuhës angleze të folur dhe të shkruar.
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative.
- Të ketë standarde të larta të integritetit.

Aplikanti duhet të dorëzojë:

- Letër motivimi
- Curriculum vitae
- Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

Afati i aplikimit: 11.09.2023, ora 16:00

E-mail: Burime.Njerezore@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D’Ark nr. 2, Tiranë.